

VENDIM
Nr.214, datë 25.7.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS
“RFI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja dhe radio me përsëritës”, të miratuar me vendimin nr.26, datë 23.10.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ambasadës Franceze në Tiranë, si dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik me përsëritës “RFI”, për ritransmetimin e programeve të huaja.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.4.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati